

Në bazë të nenit 146 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Konkluzionit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë numër 07-5588/13 të miratuar në seancën e mbajtur më 30 dhjetor 2008, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2009 i miratoi këto

KONKLUZIONE:

- 1) Propozim-ligji për plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore, jepet në diskutim publik.
- 2) Propozim-ligji për plotësimin e Ligjit të procedurës kontestimore bashkë me këto konkluzione, do të botohen në gazetat “Dnevnik”, “Shpic”, dhe “Lajm”.
- 3) Thirren qytetarët, institucionet publike, institucionet, shoqatat e qytetarëve, partitë politike, sindikatat dhe subjektet e tjera të interesuara, që mendimet dhe propozimet e tyre për Propozim-ligjin për plotësim të Ligjit për procedurë kontestimore t'ia drejtojnë drejtpërsëdrejti Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 11 maj 2009 (e hënë).
- 4) Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë e përcjell diskutimin publik, i mbledh dhe i rregullon mendimet dhe propozimet e shprehura dhe përgatit raport për rezultatet e diskutimit publik dhe të Propozim-ligjit për leximin e dytë.

KRYETAR
i Komisionit për sistem politik dhe
marrëdhënie ndërmjet bashkësive
Zoran Petreski

_____ 2009
Shkup

Republika e Maqedonisë
MINISTRIA E DREJTËSISË

PROPOZIM-LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PROCEDURË
KONTESTIMORE

Shkup, dhjetor 2008

HYRJE

I. VLERËSIMI I GJENDJEVE NË SFERËN E CILA DUHET TË RREGULLOHET ME LIGJIN DHE ARSYET PËR MIRATIMIN E LIGJIT

Ministria e Drejtësisë duke u ballafaquar me sfidën për ta krijuar transferimin e atyre lëndëve përmbarese të cilat do të mund tu transferohen përmbareseve që në fillimin e shkurtit të vitit 2008 filloi me përgatitjet për analizën e lëndëve përmbarese të cilat gjenden në gjykatat. Gjithçka filloi me analizë të përgjithshme të të dhënave statistikore të cilat gjykatat ia dorëzojnë Ministrisë së Drejtësisë dhe menjëherë konstatohet se gjendja e tillë e paraqitur e lëndëve as për së afërmi nuk i përshtatet gjendjes reale me lëndët përmbarese të ata.

Kryesisht, Gjykata themelore Shkupi 2 në raportet e veta vite me rradhë përmbyllur me 31.8.2008 tregon numër nga 40-të mijë lëndë, edhe pse e din se vetëm një kreditor (EVN) në gjykatën e njëjtë ka një numër të madh të lëndëve përmbarese. Numri i lëndëve nga ndërmarrjet tjera komunale në Shkup ende është i panjohur për Ministrinë e Drejtësisë. Gjykata themelore Shkupi 2 përmbyllur me 15.11.2008 e precizoi numrin e përgjithshëm të lëndëve përmbarese në punë para gjykatës për 319 175 lëndë, prej të cilave vetëm 4 671 janë të dhëna në bazë të aktgjykimeve gjyqësore, nëse ato të mbeturat janë lëndë me dokumente autentike nga ndërmarrjet komunale (EVN, Vodovod, Toplifikacia.....). Gjatë kësaj kreditori më i madh është EVN numri i lëndëve të të cilit e tejkalon numrin 186 000. Kjo gjykatë nuk është përjashtim dhe gjendja e tillë përsëritet pothuajse në të gjitha gjykatat në vend.

Ministria e Drejtësisë, duke u ballafaquar me njohuritë e këtilla humbëse, e nga ana tjetër përpjekja për krijimin e sistemit efikas për shpërndarjen e lëndëve të përmbarese, u ballafuq me nevojën e shqyrtimit të gjendjes reale me lëndët përmbarese në çdonjërin nga gjykatat.

Për realizimin e qëllimit të përcaktuar, Ministria e Drejtësisë për mbështetje pa rezervë dhe jo egoiste në Projektin për implementimin e reformave në jurisprudencën/USAID, e cila e mbështet dhe e ndihmon Ministria e Drejtësisë që nga fillimi i reformës së përmbaremit në Republikën e Maqedonisë, filloi procesi i skenimit të lëndëve përmbarese. Pas procesit të skenimit Ministria e Drejtësisë krijoi mënyrë krejtësisht të re të analizimit të lëndëve përmbarese në gjykatat, e cila mundësoi fitimin e pasqyrës reale për numrin e përgjithshëm dhe strukturën e lëndëve përmbarese në të njëjtat. Kjo para së gjithash ishte e nevojshme për precizimin e numrit të lëndëve të cilat do të duhej të transferohen të përmbarese, krijimin e sistemit për transferim, shmangien e ngarkesës së dyfishtë të kreditorëve me avancimin e shpenzimeve të përmbaremit dhe të ngjashme.

Të dhënat nga kjo analizë tregojnë gjendjen vijuese me dokumentet autentike në Republikën e Maqedonisë:

- Numër i madh i lëndëve rreth 77% bien në dokumentet autentike. Përqindja e lëndës që kanë të bëjnë me dokumentet autentike të cilat përsëri e kanë statusin e dokumenteve përmbarese (ishin dorëzuar në rregull dhe ishin bërë të plotfuqishme) në pajtim me Ligjin për përmbarese që është i ndryshëm dhe ndryshon nga gjykata në gjykatë. Për shembull në gjykatat themelore në Prilep, Kumanovë dhe Gostivar përqindja është rreth 35%, Gjykata themelore e Tetovës 16%, që në Gjykatën Themelore të Shkupi 2 kjo përqindje lëviz rreth 18%.
- Numri i lëndëve sipas dokumentit autentik për të cilat kreditorët i kanë paguar taksat gjyqësore, e kalon numrin 306 386 mijë dhe i krahasuar me numrin e përgjithshëm të lëndëve përmbarese të evidentuara të deritanishme është 46%.

Vetëm të dhënat e EVN-së Shkup, si kreditor më i madh në shtet, të përpunuara nga Projekti, tregojnë se taksat janë paguar sipas të gjitha propozimeve për përmbarese. Por përsëri përqindja e dokumenteve autentike të pa kryera te ata e tejkalon përqindjen prej 81%. Kjo ka të bëjë me faktin se dokumentet e këtilla fare nuk ju janë dorëzuar debitorëve vite me radhë, e në lëndën përveç një ekzemplari të shtypur të Propozimit për përmbarese nuk ka asgjë tjetër. Problem të madh paraqet fakti se EVN (pjesë e ESM-së së mëparshme), por edhe ndërmarrjet tjera komunale ishin të lëna që vet ta zbatojnë procedurën përmbarese 20 vjet me radhë. Nëse më parë arsyeja është kërkuar në atë se bëhej fjalë për ndërmarrjet publike, fakt është se ndërmarrjet komunale kanë kaluar më në pronësi private – disa prej tyre edhe te personat e huaj që e bën të ndaluar delegimin e mëtutjeshëm të kompetencës gjyqësore te të njëjtit.

Me Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përmbarese rregullohet mënyra në të cilën do të bëhet transferimi i lëndëve përmbarese nga gjykatat te përmbaresit dhe shtohen dispozitat për veprim sipas propozimit për miratimin e aktvendimit, me të cilin lejohet përmbarese në bazë të dokumenteve autentike, me të cilat parashihen propozimet për lëshimin e urdhërpagesave në bazë të dokumentit autentik të parashtrihen te noterët, të cilët do të miratojnë aktvendim me të cilin lejohet përmbarese. Me ankesë kundër aktvendimit me të cilin lejohet përmbarese, vendos gjykata në rajonin e të cilit është selia e noterit te i cili është parashtruar ankesa.

Me propozim-ligjin për plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore përjashtohen propozimet për lëshimin e urdhërpagesave në bazë të dokumentit autentik nga kompetenca e gjykatës, për arsye se bëhet fjalë për situata jokontestuese. Gjykatat duhet të veprojnë vetëm në situatat kontestuese, përkatësisht vetëm në situata ku ka të drejtë për ndarje. Lëshimi i urdhërpagesave në bazë të dokumentit autentik në esencë është situatë jo

kontestuese në të cilën nuk bën pjesë i padituri, sepse gjykata e jep në bazë të dokumenteve autentike. Gjykata mund të veprojë ndaj propozimit për lëshimin e urdhërpagesës vetëm nëse kreditori dëshmon se ka interes juridik. Me plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore noterët do të veprojnë me këto lëndë me procedurë për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik, e rregulluar në Ligjin për përmbarim. Në këtë mënyrë gjykatat do të shkarkohen nga lëndët e regjistruara sipas padis me propozim për lëshimin e urdhërpagesës, me çka do të mundësohej krijimi i kushteve për veprim efikas me lëndët të cilat paraqesin kompetencë të vërtetë gjyqësore – vendimmarrje me lëndë kontestuese civile dhe ekonomike, procedura falimentuese dhe vendimmarrje për përgjegjësi penale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në procedurat penale.

II. QËLLIMET, PARIMET DHE AKTVENDIMET THEMELORE

Qëllimi i aktvendimeve të propozuara ligjore është krijim i gjykatës efikase dhe shkarkimi i gjykatave nga numri i madh i lëndëve të regjistruara si padi me propozim për lëshimin e urdhërpagesës, në bazë të dokumenteve autentike. Me aktvendimin e propozuar ligjor përjashtohen nga kompetenca e gjykatës propozimet për lëshimin e urdhërpagesave në bazë të dokumenteve autentike. Me propozimet për lëshimin e urdhërpagesave në bazë të dokumenteve autentike do të veprojnë noterët në procedurë me propozim për miratimin e aktvendimit me të cilin lejohet përmbarimi në bazë të dokumentit autentik e cila është e rregulluar me Ligjin për përmbarim.

III. VLERSIMI I PASOJAVE FINANCIARE NGA PROPOZIM-LIGJI PËR BUXHETIN DHE MJETET TJERA PUBLIKE FINANSIARE

Propozim-ligji për plotësim të Ligjit për procedurë kontestimore nuk shkakton implikime financiare për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

IV. VLERSIMI I MJETEVE TË NEVOJSHME FINANCIARE PËR ZBATIMIN E LIGJIT, MËNYRA E SIGURIMIT TË TYRE DHE TË DHËNA PËR ATË SE ZBATIMI I LIGJIT A TËRHEQË OBLIGIME MATERIALE PËR SUBJEKTE TË NDARA

Për zbatimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara nuk nevojitet sigurim i mjeteve financiare.

V. LIGJET TË CILAT DUHET TË NDRYSHOHEN DHE DALIN NGA MIRATIMI I KËTIJ LIGJI

Miratimi i propozim-ligjit për plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore duhet të sillet në pako me ndryshimet e Ligjit për përmbarim, për arsye të rregullimit të procedurës për miratimin e aktvendimit me të cilën lejohet përmbarim në bazë të dokumentit autentik.

PROPOZIM-LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PROCEDURË KONTESTIMORE

Neni 1

Në Ligjin për procedurën kontestimore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 79/2005 dhe 110/2008) në nenin 418 pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5) si vijon:

“(4) Kur në bazë të dokumentit autentik, kreditori mund të kërkojë nga noteri të miratojë aktvendim me të cilën lejohet përmbarimi, gjykata do të lëshojë urdhërpagesë vetëm nëse paditësi, e bën të sigurt ekzistimin e interesit juridik për lëshimin e urdhërpagesës.

(5) Nëse paditësi nuk e bën të sigurt ekzistimin e interesit juridik për lëshimin e urdhërpagesës, gjykata do ta refuzojë padinë.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

ARSYETIM I PROPOZIM-LIGJIT

II. SQARIM I PËRMBAJTJES SË DISPOZITAVE TË PROPOZIM-LIGJIT

Propozim-ligji për plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore, është i sistematizuar në dy nene të ligjit. Me nenin 1 plotësohet neni 481 me shtimin e dy paragrafëve të rinj (4) dhe (5) me të cilët verifikohet se kur në bazë të dokumentit autentik, kreditori mund të kërkojë nga noteri të miratojë aktvendim me të cilin lejohet përmbarimi, gjykata do të lëshojë urdhërpagesë, vetëm nëse paditësi e bën të sigurt ekzistimin e interesit juridik për lëshimin e urdhërpagesës. Nëse paditësi nuk e bën të sigurt ekzistimin e interesit juridik për lëshimin e urdhërpagesës, gjykata do ta hedh poshtë aktpadinë.

Me nenin 2 rregullohet data e hyrjes në fuqi të Ligjit për plotësimin e Ligjit për procedurë kontestimore.

II. LIDHSHMËRIA NDËRMJET ZGJIDHJEVE TË PËFSHIRA NË DISPOZITAT E PROPOZUARA

/

III. PASOJAT QË DO TË DALIN NGA ZGJIDHJET E PROPOZUARA

Me zgjidhjet e propozuara ligjore, do të fillojë procesi i zvogëlimit të numrit të lëndëve, të cilat gjenden para gjykatave të Republikës së Maqedonisë, të cilat vite më parë e ngarkojnë gjykatën maqedonase. Numri më i madh i lëndëve para gjykatave maqedonase, janë propozime për lëshimin e urdhërpagesave në bazë të dokumenteve autentike. Me bartjen e kompetencës për veprimin ndaj propozimeve për lëshimin e urdhërpagesave për miratimin e aktvendimeve me të cilat lejohet përmbarimi në bazë të dokumenteve autentike prej gjykatave te noterët, do të mundësohet krijimi i kushteve për veprim efikas ndaj lëndëve të cilat paraqesin kompetencë të vërtetë gjyqësore-vendimmarrje për lëndët kontestuese civile, procedura të falimentimit dhe vendimmarrje për përgjegjësinë penale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në procedurat penale. Me këtë do të bëhet edhe një hap përpara në realizimin e qëllimit deri në fund, e ajo është krijimi i gjykatës efikase në Republikën e Maqedonisë.

TEKSTI I DISPOZITAVE TË LIGJIT PËR PROCEDURË KONTESTIMORE TË CILAT PLOTËSOHEN

Neni 418

- (1) Kur kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesën e arritur me para, dhe kjo kërkesë vërtetohet me dokumentin autentik të bashkangjitur padisë në origjinal ose në kopje të verifikuar, gjykata do t'i lëshojë urdhëresë paditësit, ta plotësojë kërkesën e paditës (urdhërpagesë).
- (2) Si dokumentet autentike konsiderohen veçanërisht:
 - 1) dokumentet publike,
 - 2) dokumentet private, në të cilat nënshkrimin e obliguesit e ka verifikuar organi kompetent për verifikim,
 - 3) kambiale dhe çëçe me protestë dhe me llogari kthyesë nëse ato janë të nevojshme për themelimin e kërkesës,
 - 4) certifikata të librave të verifikuara afariste,
 - 5) faturat dhe
 - 6) dokumentet të cilat, sipas dispozitave të veçanta kanë rëndësi të dokumenteve publike.
- (3) Gjkata do të lëshoj urdhërpagesë edhe pse paditësi në padinë, nuk ka propozuar lëshimin e urdhërpagesës, e janë plotësuar të gjitha kushtet për lëshimin e urdhërpagesë.